



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.69/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen paraprake, kundër përfaqësueses së palës së dëmtuar- avokates Saranda Keqekolla-Sadiku , duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i përfaqësueses së palës së dëmtuar, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PN.nr.251/22 të datës 25.09.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm PN.nr.nr.1247/23 të datës 16.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.02.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Hedhet si e papranueshme kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i përfaqësueses së palës së dëmtuar-avokates Saranda Keqekolla-Sadiku, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PN.nr.251/22 të datës 25.09.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm PN.nr.nr.1247/23 të datës 16.10.2023.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin PN.nr.251/2022 të datës 25.09.2023, në çështjen paraprake PN.nr.251/22, të datës 25.09.2023, përfaqësueses së palës së dëmtuar-avokates Saranda Keqekolla-Sadiku, për shkak të fyerjes së gjykatës, integritetit profesional dhe personal të gjyqtarës të procedurës paraprake i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) €, të cilën obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.nr.1247/2023 e datës 16.10.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të përfaqësueses së palës së

dëmtuar avokates Saranda Keqekolla-Sadiku, ndërsa aktvendim e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër aktvendimeve të kundërshtuara, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar i mbrojtësi i përfaqësueses së palës së dëmtuar Saranda Keqekolla-Sadiku, për shkak të shkeljes së drejtës materiale dhe shkeljes së dispozitave procedurale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoi kërkesën si të bazuar dhe ti anuloi aktvendimet e kundërshtuara me kërkesë.

Zyra e Kryeprokurori të Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.40/2024 e datës 31.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të hedhet si e papranueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 435 paragrafi.1 dhe paragrafi.2 të KPP-së, i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e papranueshme.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, sipas dispozitës së nenit 432 par.1 të KPP, mund të ushtrohet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë.

Në rastin konkret, siç rezulton nga shkresat e çështjes, aktvendimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa, me të cilin aktvendim përfaqësueses së palës së dëmtuar i është shqiptuar gjyba, të njëjtat nuk mund të konsiderohen vendime të formës së prerë me të cilin ka përfunduar procedura penale për faktin se nuk kemi të bëjmë me procedurë penale për të cilën me aktgjykim të formës së prerë është shpall fajtor për ndonjë vepër penale, prandaj kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në këtë rast nuk është e lejuar.

Edhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale përkatësisht nenit 433 paragrafi 1 të këtij kodi, parashihet se kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqesë Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij”.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 435 par.2 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.69/2024, më datë 06.02.2024

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Afrim Shala